

Agr. LIDA LAZAJ

Paketë Teknologjike

Prodhimi i fidanëve të ullirit me anë të shartimit.

Një nga prioritetet e Qeverisë shqiptare vitet e fundit është mbjellja e ullishteve të reja. Në këtë kuadër u bë edhe studimi mbi gjëndjen aktuale të ullishtarisë dhe perspektivat e zhvillimit të sajë ku është parashikuar të prodhohen cdo vitë 2.8 milion fidanë dhe 80% e tyre më anë të shartimit.

Nisur nga ky objektivi i madh del e nevojshme përsosja dhe njohja e teknologjisë së prodhimit të fidanëve me shartim dhe shtimi i sipërfaqeve të fidanishteve dhe në këtë kuadër Q.T.T.B Vlorë ka rolin e saj.

Prodhimi i fidanëve të ullirit me shartim kalon në dy faza:

I- Prodhimi i fidanit të nënshartesës.

II-Shartimi dhe shërbimet e mëtejshme deri në arritjen e fidanit standart për shitje.

Prodhimi I i fidanëve të nënshartesës së ullirit ka një teknologji të vecantë hallkat e së cilës shkurtimisht po I trajtojmë më poshtë.

a-Nxjerja e farës: Më të përshtatshëm për të marë frutat nga të cilat do të nxiren farat për mbjellje janë “Ullastra” dhe kultivarët e ullirit “Lecino”, “Ulliri Hollë I Himarës”, “Maurino”. Kultivari “Frantoio” I cili është përdorur deri tani nuk rekomandohet pasi është I predispozuar për tu prekur më shumë nga turbekulozi.

Vjelja e frutave bëhet kur ato kanë arritur pjekjen e plotë botanike. Nxjerja e farës bëhet menjëherë pas vjeljes pasi frutat e freskët e favorizojnë më mirë këtë proces. Ulliri futet në thasë, shtypet fort me këmbë deri sa të ndahet bërthama nga tulli dhe shplahet disa herë me ujë të rrjedhshëm me qëllim që të largohet bërsia. Është mirë që në fund farat të shplahen me tretësirë hipoklorit sode 4-5% për të hequr nga bërthama cdo mbetje tulli. Pasi fara është pastruar hapet në sheshë në ambient të hijezuar dhe të ajrosur duke e përzier vazhdimisht që të mos krijohet mykë dhe të kalbëzohet për disa ditë deri sa të thahet plotësisht. Fara më pas hidhet në thasë beze dhe ruhet në hije dhe në temperaturë të ulët.

b-Zgjimi: Fara e ullirit ashtu si gjithë farat me guackë duhet të kalojë periudhën e zgjimit e cila për ullirin zgjat minimalisht 60 ditë dhe që përkon me fundin e muajit Maj dhe fillimin e muajit Qershor. Materiali më i mirë për zgjim është rëra e lumit. Ky është një proces shumë delikat sepse embrioni duhet të aktivizohet por jo të kalbet, të thahet apo

celi më shumë se 20-25% e farave. Kjo arrihet duke e mbajtur farën në ambient të freskët, lagështinë nën kontroll dhe duke e përzier vazhdimisht.

c-Përgatitja e farishtes: Farishtja mund të ndërtohet në ambient të hapur ose në serrë nëse janë mundësitë. Gjerësia e farishtes është 1.2-1.5 m dhe gjatësia sipas vëndit dhe sasisë së farës që do mbillet. Tabanit të farishtes i hidhet një shtresë zhavori 15-20 cm për drenazh, me pas dhe' i shkrifët dhe i situar në trashësi 35-40 cm dhe shtresa e sipërme deri në 10 cm rërë lumi. Kjo është një mënyrë por ka edhe eksperiencia ku farishtja bëhet 100% me rërë lumi dhe jep rezultate të mira në % e mbirjes.

Pasi materiali hidhet në farishtet shpërndahet, nivelohet, ngjishet dhe në fund vaditet me shoshë që t'mos krijohen disnivele në sipërfaqe. Është e domosdoshme që dherishtja të desinfektohet me preparate kundër kërpudhave që shkaktojnë kalbëzimin e qafës së rrënjës nga e cila preken shumë farishtet.

d-Mbjellja e farës: Përiudha e mbjelljes së farës varion nga muaji Qershor deri në Shtator por muajt Korrik-Gusht janë më të përshtatshëm. Fara e cila ka kaluar periudhën e zgjimit pastrohet nga rëra me anë të një site, shplahet dhe vendoset për dy ditë në ujë. Mbjellja bëhet duke e shtruar farën "kalldrëm", mbulohet me rërë në trashësi 4-5 cm, ngjishet dhe vaditet përsëri me shoshë. Për 1m² farishte përdoret 5-6 kg farë dhe merren afërsisht 700-800 filiza. Nisur nga shifrat e mësipërme si dhe faktin që nga 1 kv fruta merren rreth 40 kg farë cdo fidan prodhues llogarit sasinë e farës dhe sipërfaqen në varësi të objektivit që ka.

e- Shërbime të mëvonëshme në farishte:

-Duke qënë se fara mbillet në verë kur temperaturat janë të larta dhe rrezatimi i madh është mirë që farishtja të hijëzohet.

-Vaditje të vazhdueshme për të stimuluar mbirjen por edhe të kontrolluara për të evituar kalbëzimin. Rekomandohet që vaditjet të shoqerohen me preparate që parandalojnë kalbëzimin.

-Pastrim nga barërat e këqia dhe ajrosje të vazhdueshme.

-E trajtuar si më sipër fara fillon të mbijë nga mezi i muajit tetor e në vazhdim dhe nëse farishtja është në ambient të hapur në këtë periudhë duhet të mbulohet me plasmë.

f-Trapiantimi i filizave: Për mbjelljen e filizave janë përdorur dy metoda:

E para- Nga farishtja në qeskë definitive. Fundi i muajit Mars dhe gjithë muaji Prill është periudha më e përshtatshme për trapiantimin e filizave. Qeskat mbushen më parë me dherishte (përzjerje dheu, pleh, torfë ose rërë) dhe rradhiten në vëndin e përhershëm. Filizat shkulen me kujdes me lopat që t'mos u dëmtohet sistemi rrënjor, banjëzohen në

tretësirë bajge të freskët ose me preparate kimike që rekomandohen për mbrojtjen nga kalbëzimi. Mbjellja bëhet me anë të një kunjje duke vendosur filizin në mesin e qeskës së mbushur dhe ngjishet lehtë. Menjëherë pas mbjelljes bëhet vaditja me shoshë që bima ta thithi ujin ngadalë, të marrë sasinë e nevojshme të ujit, nuk largohet dhe nuk dëmtohet sistemi rrënjor. Kur ekzistojnë mundësitë në momentin e trapiantimit është mirë që bimët të vendosen në ambient të hijëzuar.

E dyta- nga farishtja në kubik të vegjël (kokodashe) dhe pastaj në fushë ose në qeska plasmasi.

Në muajin janar kur filizat në farishte kanë formuar një çift gjethesh, shkulen, bëhen kokodash dhe shtratifikohen përsëri për tu mbjellë në muajin prill në qeska ose në vëndin e përhershëm në tokë. Gjatë kohës që rishtratifikohen te filizat vashdojnë shërbimet njësoj si në farishte. Masa që përdoret për të bërë kubikët përgatitet me dhe' të shkrifët dhe të situr dhe me pleh organik të kalbur mirë në masat 50 me 50%. Ngjishet fortë deri sa të punohet mirë në dorë.

Eksperienca e Q.T.T.B Vlorë ku filizat e përgatitur si më sipër mbillen direkt në tokë në vllaja rezultoi pozitive. Vllajat përgatiten me një gjerësi 1m dhe gjatësi jo më shumë se 50 m, të ngritura 5-8 cm nga toka. Mbjellja bëhet me anë të një kunjje në rreshta në distancë 15x20 cm, ngjishen dhe vaditen menjëherë. Avantazhet e kësaj metode janë:

- Duke qënë "kokodash", filizi është më i zhvilluar se ai në farishte sepse ka patur me shumë terren ushqyes.

-Mundësia për moszënie është minimale.

-Përshtatet më shpejtë dhe më mirë me ambientin e ri duke eliminuar frenimin që pëson bima kur kalon nga një gjëndje në një tjetër.

Shërbime të mëtejshme në qeska apo fidanishte:

-Vaditje të vazhdueshme sidomos pas mbjelljes.

-Plehim kimik për të stimuluar rritjen cdo 10-15 ditë.

-Pastrim i barërave të këqia që konkurojnë bimën.

-Pastrim i pjesës fundore të nënshartesës që në fazat e para behet me dorë dhe që t' mos drynjëzohen dhe t' mos përdoret gërshëra për të evituar plagët.

Duke zbatuar me rigorozitet teknologjinë e mësipërme fidanët janë gati për shartim në pranverën e vitit pasardhës.

Shartimi dhe shërbimet e mëvonëshme deri në arritjen e fidanit standart:

Shartimi është hallka më e rëndësishme në të gjithë zinxhirin e hallkave nëpër të cilin kalon prodhimi i fidanëve të ullirit. Kalemata që përdoren për shartim duhet të merren nga bimë të reja dhe të pastra nga ana fitosanitare dhe ajo varjetore dhe për këtë duhet të kushtohet një kujdes i vacantë parcelave mëmë për marrjen e kalemave për shartim.

Në vendin tonë përse i përket shtimit të ullirit me anë të shartimit përdoret vetëm shartimi me kalem. Gjatë vitit 2011 në Q.T.T.B Vlorë u bënë prova për shartimin me syth në ulli të cilën do ta trajtoj shkurtimisht në këtë paketë.

Shartimi me kalem: Koha e kryerjes së këtij shartimi varjon nga 25 Mars-25 Prill por periudha më e mirë është 15-ditëshi i parë i muajit prill. Kushtet atmosferike duhet të jenë të përshtatshme, jo në mot me erë dhe shi sepse kanë një ndikim shumë negativ në % e zënies dhe në stimulimin dhe përhapjen e infeksionit.

Metodologjia e shartimit: Pritet nënshartesa në lartësinë 6-8 cm nga toka me pak pjerësi në anën ku do të mbështetet kalem i mbishartesës. Kalem i përgatitet me një çift gjethesh dhe me gjatësi 3-3.5 cm. Lëkura cahet me brisk të mprehtë gati 1.5 cm dhe nëse bima është në kondicionet e duhura kalem i can vetë lëkurën. Menjëherë pas vendosjes së kalemit bëhet lidhja me rrafje dhe izolimi me mastic të pika e shartimit dhe maja e kalemit me qëllim ruajtjen e lagështisë dhe freskisë së kalemit. Herë pas here mjetet e shartimit dizinfektohen me alkool për të shmangur transmetimin e sëmundjes së turbekulozit nga njëra bimë te tjetra.

Shërbime pas shartimit:

-Vaditje e vazhdueshme me qëllim që të ndihmojë lëvizjen e lëngjeve dhe ngjitje të shpejtë të dy pjesëve të shartimit.

-Pastrim i barërave të këqia cdo 15 ditë.

-Shkrifërim i bukës së dheut kur bimët janë në qeskë.

-Zgjidhja e shartimit bëhet kur lastarët e celur arrijnë lartësinë 15-25 cm dhe kjo përkon me peridhën 15 ditëshi i dytë i muajit korrik e në vazhdim. Gjatë këtij procesi bëhet edhe verifikimi i zënieve të shartimit dhe sistemimet e nevojshme.

Pas kësaj fillon një fazë e re pune për përgatitjen e fidanit standart për shitje ku vec shërbimeve që u përmendën më lartë duhet të bëhen me rigorozitet edhe këto shërbime:

-Plehrime cdo 10 ditë me plehra kristalor që stimulojnë rritjen dhe zhvillimin e fidanit.

Heqja e krahëzave të nën dhe mbishartesës në momentin që ato janë të pa drunjëzuara pa përdorur gërshërë.

-Vendosje dhe lidhje kallama për drejtimin e fidanit.

-Spërkatje të vazhduesme për të luftuar sëmundjet dhe dëmtuesit sipas kalendarit.

-Krasitje për formimin e kurorës në lartësinë 80 cm nga toka. Në këtë proces duhet vazhdimisht të desinfektohet gërshëra krasitëse.

Duke zbatuar teknologjinë e mësipërme rreth 60-70% e fidanëve janë gati për tu shitur në fund të vitit të parë apo 3- mujorin e parë të vitit pasardhës.

Shartimi me syth:

Përgatitjen e fidanit të nënshartesës e trajtuam më lartë dhe në ato standarte duhet të jetë edhe për shartimin me syth, fidan i drejtë , pa nyje dhe me diametër 6-7mm. Afati i shartimit është 20 Prill-10 Maj (nëse sigurojmë kalemata e mbishartesës). Teknika e shartimit është e njëjtë me shartimin me syth në agrume. Lëkura cahet në formën e germs "T" në lartësinë 25-35 cm dhe në të vendoset sythi i prerë në formë "pyke" me pak dru. Menjëherë bëhet lidhja me rrafje ose material plastik që përdoret për këtë qëllim. Shërbimet pas shartimit janë të njëjta me ato që bëhen në shartimin me kalem.

Nga prova që u bë në fidanishten e Q.T.T.B. % mesatare e zënies së shartimit rezultoi 58%. Periudha e celjes së sythave ishte relativisht e gjatë duke filluar nga muaji Qershor-Gusht. Zhvillimi i mëtejshëm i bimës së shartuar është normal me rritje mesatare të lastarit 40 cm deri në fund të muajit Nëntor të vitit të parë.

Në vazhdim të kësaj pakete jepen në formë kalendari trajtimet kimike që duhet të bëhen përt të luftuar disa nga sëmundjet dhe dëmtuesit kryesor që prekin filizat dhe fidanët e ullirit si dhe shërbimet agroteknike gjithëvjetore.

Kalendar per trajtimet kimike per disa nga demtuesit dhe semundjet kryesore qe prekin fidanet e ullirit.

Sëmundja Dëmtuesi	Preparati	J	SH	M	P	M	Q	K	G	SH	T	N	DH
Tënja jeshile Margaronia	Azinphos Methyl, Endosulfan (thiodan), Carbaryl, Parathion, (tetrafos Thiofos), Folimat, Aminer	-	-	-	-	-	x	x	-	x	x	x	-
Hundgjati	Sevin, Arvin, Gusathion, Benzafol.	-	-	-	-	-	x	-	-	-	x	-	-
Tripsi	Carbaryl, Azinphos Methyl, Methamidophos (tamaron)	-	-	-	-	-	x	x	-	x	x	-	-
Turbekulozi	Oksiklorur, Sulfat, Hidroksid i bakrit	-	-	-	x	x	-	-	-	x	x	x	-
Syri i palloit	Preparatet e mësipërme, Dodinë	-	-	-	x	x	-	-	-	x	x	-	-
Kalbëzimi qafës së rrënjës	Nabam, Thiram, Dazomet, Previkur. etj	x	x	x	-	-	-	-	x	x	x	x	x

Kalendar shërbimesh agroteknike në filizat e nëshartesës dhe fidanë të ullirit.

Muaji	Farishte, nënshartesa viti I dhe II	Fidan të shartuar deri në shitje
Janar	-Trapiantimi në kubik dhe rishtratifikimi i filizave -Ujitje, spërkatje (kundër kalbëzimit), ajrosje.	-Vazhdon shitja e fidanëve.
Shkurt	-Ujitje, sperkatje, ajrosje në farishte -Pastrim bari në fushë.	-Shitje fidan i rritur. -Shërbime në fidanët që nuk janë standart për shitje.
Mars	-Shërbime në farishte për kalitjen e filizit. -Përgatitja e vëndit për mbjellje. -Grumbullimi bazës materiale si qeska etj. -Shërbime në fidanat që do shartohen si vaditje, pastrim bari, plehrim. -Përgatitja për shartim.	-Mbjellje fidanishteve të reja. -Shërbime sipas kushteve si pastrim bari, ujitje etj.
Prill	-Mbjellja e filizave në fushë ose qeskë. -Vaditje, pastrim bari.	-Shartim i fidanëve. -Shërbime agroteknike në fidanët e posashartuar dhe në ato të vitit të dytë.
Maj	-Vaditje, pastrim bari, plehrim, shkriferim. -Vendosje e fares per zgjim.	-Vazhdojnë shërbimet intensive si vaditje, pastrim bari, spërkatje, plehrime, shkrifërim, mbrojtja nga kermilli i sytheve të sapocelur.
Qershor	-Vaditje, pastrim bari, plehrim, heqje krahëzash, shkrifërim. -Trajtim i farës së vënë në zgjim.	-Shërbime agroteknike. -Spërkatje kundër sëmundjeve dhe dëmtuesve.
Korrik	-Shërbimet e mësipërme si dhe kujdesi për farën e vënë në zgjim (përzjerje dhe ujitje). -Përgatitja e farishtes.	-Shërbime në fidanët e rinj, heqje krahëzave, spërkatje kunder dëmtuesve. -Fillon zgjidhja e shartimeve.
Gusht	-Mbjellja e farës në farishte dhe shërbimet në të, hijezimi. -Vaditje, plehrime, pastrim bari në fushë, shkrifërim. -Heqje e krahëzave dhe krasitjet e nevojshme.	-Vazhdon zgjidhja e shartimeve. -Shërbime agroteknike si pastrim bari, vaditje, plehrime, shkrifërim.

Shtator	-Vazhdojnë shërbimet në farishte dhe fidanishte si më lartë.	-Spërkatje për sëmundje dhe dëmtues. -Shërbimet agroteknike në vazhdim, plehrim me plehëra kristalor 2-3 herë. -Vendosje dhe lidhje kallama për drejtimin e fidanit.
Tetor	-Vaditje në varësi të kohës, -mbulim i farishtes me plasmas nëse është jashtë. -Spërkatje në farishte kundër kalbëzimit.	-Krasitje për formimin e kurorës. -Spërkatje për dëmtuesit. -Plehrim, shkrifërim i bukës së dheut.
Nentor	-Vjelja e ullirit dhe nxjerja e farës, tharja dhe ruajtja e saj në thasë bezeje. -Trajtime në farishte, ajrosje, vaditje, spërkatje. -Shërbime në fushë sipas nevojës.	-Spërkatje kundër tënjës jeshile. -heqje krahëzave. -shërbimet e tjera sipas nevojës
Dhjetor	-Shërbime në farishte,vaditje, Spërkatje,ajrosje.	-Marrja e masave për shitjen e fidanëve (certifikatat dhe garancia fitosanitare) -Ambalazhimi i fidanëve nëse janë në tokë. -Fillon shitja.

Agr.Lida Lazaj